

APEL PUBLIK PER PRONAT DREJTUAR KËSHILLIT TE LARTË TË DRJTËSISË DHE AMBASADORËVE

Në emër të kryesisë së Shoqatës "Bregdeti" urojmë Presidentin e Republikës z. Bujar Nishani kryetar dhe z. Elvis Cefa, nënkryetar i KLD dhe kërkojmë që KLD e rinovuar, të vendosi drejtësi, të zbatojnë kushtetutën për të çliruar pronat që kanë pushtuar pas vitit 1991 grabitqarët, fenomen që është shumë i theksuar në bregdetin turistik. Detyrohemi të reagojmë me këtë shkrim pasi me datën 21.08.2011 dëgjuaam intervistën televizive të Ministrit të Drejtësisë, z. Eduard Halimi, për hartën e vlerës së tokave në përputhje me çmimin e tregut që ti hapet rrugë kompensimit fizik që do fillojë në vitin 2013.

Zoti Çefa nga eksperiencia e punës në Agjensi njih shumë nga zullumet e bëra me pronat për shkak të ligjeve të gabuara që ai ka qenë i detyruar ti zbatojë si dhe për shak të korrupsionit në zbatimin e gabuar të këtyre ligjeve.

Vendimi i Qeverisë për të shembur ndërtimet pa leje të personave të tretë në bregdet është një fillim i mirë por demokracia kërkon që shteti të çlirojë pronat tona nga pushtimi dhe grabitja që kanë realizuar politikanët pas vitit 1991.

Ne kërkojmë nga KLD, në përbërje të të cilës janë z. Bujar Nishani, z. Elvis Cefa dhe Ministri i Drejtësisë, ti hapin rrugë të drejtës kushtetuese të qytetarëve që secili të gëzojnë pronat e trashëguara, në të kundërt ata do të jenë vrasësit, shkatëruesit e popullit dhe të demokracisë. Kërkojmë që KLD të analizojnë letrat e shumta për këtë problem, kërkesën tonë të fundit botuar vetëm nga "Zëri Popullit" datë 11.08.2012 kërkesat e Shoqatës "Pronësi me Drejtësi" botuar ne gazetat "Dielli" "Sot" "Shekulli" "Zeri Popullit" "Metropol" etj. Kërkojmë nga KLD që me një deklaratë publike në shtyp të sqarohet populli, se prona fitohet me blerje me dhurim dhe me trashëgimi dhe se kompensimi fizik pa mbaruar kthimi është vjedhje e maskuar. Regjistri elektronik dhe puna për pronat do të futet në rrugën e drejtë nëse KLD do të orientojë të bëhet dallimi se cilat janë pronat e shtetëzuara dhe cilat janë prona të shtetit dhe të bëhet konsensusi nëse do zbatohet apo do vazhdojë të shkelet Kushtetuta. A do të zbatohet neni 181 i Kushtetutës dhe në raport me nenin 8 të ligjit 7501 cili prej tyre ka prioritet. Pronat që diktatura i grabiti pas vitit 1945 me akte nënligjore janë prona për të cilat grabitësi (shteti i diktaturës) gëzon dhe të drejtën e pronësisë apo shteti demokratik ka detyrim që ato prona ti kthehen fizikisht të zotit. Këto janë detyra të theshta për KLD por të rendësishme për ardhmërinë e demokracisë.

Strategjia aktuale do të dështojë pasi gabimeve të deritnishme i shton dhe gabime të tjera. Bregdetasit, që janë pronarë të ligjshëm në trojet e tyre të trashëguara nuk do të pranojnë kompensim dhe pronat e tyre ti përvetësojnë të tjerët. Të imponsh kompensim për prona që në zbatim të nenit 181 dhe 41 të Kushtetutës duhet ti kthehen të zotit është tallje me kushtetutën, shkatërim i pronës, shkatërrim i historisë tonë, është genocid me mekanizma ligjore, është krim kombëtar.

Zyrtarisht Raporti B.Botërore justifikohet me pragmatizëm që realisht maskon kleptokracinë. Fatkeqsisht Banka Botërore me rekomandimet e saj ka qenë totalisht kundër të drejtës së pronësisë për pronarët autoktonë. Qëndrimi B. Botërore kundër pronarëve të ligjshëm, është i nivelit skizofrenik. Realisht B. Botërore është tallur me vërejtjet tona për të respektuar frymën dhe nenet e Kushtetutës veçanërisht nenit 181.

Ne kërkojmë që ambasadori i BE zoti Ettore Sequi, të shprehet publikisht për pronën tek i zoti, ashtu siç janë shprehur disa përgjigje të drejtuesve të politikës se KE,

pasi problemi më shqetësues për popullin është mohimi i pronës, vjedhja dhe përvetësimi saj në emër të ligjit nga kanet e politikës. Me kërkesn për pronat ne nuk po mohojmë rëndësinë e reformës zgjedhore , reformës në drejtësi dhe heqjes së imunitetit të cilat me shumë të drejtë zoti Sequi dhe Komisioneri Stefan Fule i kanë theksuar , por sa më teper shtyhet koha për kthimin e pronës tek i zoti dhe intrigohet kthimi fizik me kompensime më shumë krime do të shtohen dhe më shumë korrupsin do kultivohet.

Për kryesinë e Shoqatës “Bregdeti”

Niko Nesturi